

Pyetjet më të Shpeshta për Portalin Prindi & Familja

1. Çfarë është Portali Prindi & Familja?
2. Si mund t'a përdor Portalin Prindi & Familja?
3. Kush mund t'a përdorë Portalin Prindi & Familja?
4. Si mund të regjistrohem në Portal?
5. Unë kisha një llogari në Portalin e vjetër i cili tani nuk punon. Çfarë duhet të bëj?
6. Si mund të ndryshoj adresën time të email-it?
7. Unë nuk kam më akses në emailin që përdora për llogarinë time të Portalit. Çfarë duhet të bëj?
8. Si mund të ndryshoj numrin(t) e telefonit?
9. Si mund të ndryshoj fjalëkalimin, ose pyetjet e sigurisë?
10. Unë kam harruar fjalëkalimin. Si mund t'a rivendos atë përsëri?
11. Unë kam harruar emrin e përdorimit (username). Si mund t'a gjej atë përsëri?
12. Unë nuk mund të futem në llogarinë time dhe nuk kam akses në emailin e përdorur për krijimin e llogarisë. Si mund t'a rivendos përsëri llogarinë time?
13. Si mund të lidhem me llogarinë e nxënësve të mi?
14. Çfarë është Kodi i Konfirmimit (Confirmation Code)?
15. Kur më duhet Kodi i Konfirmimit?
16. Pse nuk funksionon Kodi im i Konfirmimit?
17. Si veprohet nëse nuk kam telefon, ose numrat e telefonit të listuar në rekordet e fëmijës janë shkëputur?
18. Si mund t'a di që të dhënat e fëmijës tim janë private dhe të sigurta?
19. Si mund të shikoj në rekordet shkollore të viteve të kaluara të fëmijës tim?
20. Si mund të shikoj klasat, frekuentimin dhe notat e fëmijës tim?
21. Si mund regjistrohem për marrjen e emaileve, tekst mesazheve dhe njoftimeve të tjera nga shkolla e fëmijës tim?
22. A mund të përdor ndonjë aplikim (App) për këtë qëllim në telefon, ose tablet?
23. Çfarë ikone aplikacioni mund të përdor nga platforma e Portalit Prindi & Familja?
24. Pse nuk mund të përdor ikonat e aplikacionit të platformës “ Prindi & Familja”?

-
1. **Çfarë është Portali Prindi & Familja?** Portali *Prindi & Familja* është një mundësi për ju që të keni qasje online në informacionin mësimor të fëmijës tuaj, përfshirë orarin e mësimin, frekuentimin, notat, materialet mësimore dhe rekordet e vaksinimit. Portali ju lejon gjithashtu të regjistroheni për marrjen e njoftimeve të ndryshme (si mbyllja e shkollës për shkak të motit) nga shkolla e fëmijës nëpërmjet telefonit, emailit, ose tekst mesazheve.

2. **Si mund t'a përdor Portalin Prindi & Familja?** Qasja juaj në Portalin *Prindi & Familja* mund të kryhet nga shumica e web browser_ve si: Chrome, Safari, Internet Explorer, Edge, ose Firefox”, nëpërmjet lidhjes në internet të kompjuterit, ose paisjeve të tjera.
3. **Kush mund t'a përdorë Portalin Prindi & Familja?** Portali mund të përdoret nga një prind ose kujdestar i një fëmijë që vazhdon shkollën në klasat K-12, në juridiksionin e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias. Prindërit/kujdestarët e nxënësve të shkollave charter, private ose fetare, nuk mund të kenë qasje në këtë portal.
4. **Si mund të regjistrohem në Portal?** Ju keni nevojë për një adresë personale emaili. (Nëse nuk keni email, ju mund të regjistroheni falas nëpërmjet Google, Yahoo ose shërbime të tjera të ngjashme.) Për regjistrim në llogarinë e *Portalit Prindi & Familja*, vizitoni <https://signup.philasd.org> dhe ndiqni udhëzimet që shfaqen. Për më tepër ndihmë, referohuni te faqja e udhëzimeve të Portalit, që ndodhet këtu.
5. **Unë kisha një llogari në Portalin e vjetër i cili tani nuk punon. Çfarë duhet të bëj?** Llogaritë për prindërit, që nuk kanë fëmijë të regjistruar në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias, duke filluar nga 30 Shtatori 2017, ose për një nxënës, që nuk bëhet lidhje nga kompjuteri me prindin/kujdestarin, nuk janë transferuar nga *Portali* i vjetër *Prindi & Familja*. Nëse besoni që llogaria juaj është fshirë për arsye të cituara më lart, ndiqni kapat e cituara në pyetjen 4 për regjistrim.
6. **Si mund të ndryshoj adresën time të email_it?** Ju mund të ndryshoni adresën tuaj të emailit pasi të jeni futur në llogarinë tuaj të *Portalit Prindi & Familja* dhe të klikoni në ikonën “Llogaria Ime” (“My Account”) të Platformës. Kur të bëni ndryshimin e emailit që lidhet me llogarinë tuaj, ju do të merrni një mesazh në adresën tuaj të re të emailit, bashkë me një link, që konfirmon ndryshimin. Ju duhet të klikoni në linkun që vjen me mesazhin, për konfirmimin e emailit të ri. Nëse ju nuk klikoni në link, që të përfundoni procesin, adresa e emailit të portalit nuk do të ndryshojë.
7. **Unë nuk kam më akses në emailin që përdora për llogarinë time të Portalit. Çfarë duhet të bëj?** Për përditësimin e adresës së emailit që lidhet me llogarinë tuaj, kontaktoni Zyren e Përfshirjes së Familjes & Komunitetit në numrin: 215-400-4000 ose email: ask@philasd.org.
8. **Si mund të ndryshoj numrin(t) e telefonit?** Ju mund të përditësoni numrin tuaj të telefonit duke klikuar :Informacioni i Familjes” (“Household Information”) në pjesën majtas të faqes së Portalit. Të gjithë numrat e tjerë të listuar për secilin person, menaxhohen në shkollën e fëmijës tuaj. Për përditësimin e numrave tuaj personalë, ju lutemi kontaktoni shkollën e nxënësit tuaj.
9. **Si mund të ndryshoj fjalëkalimin, ose pyetjet e sigurisë?** Ju mund të klikoni në ikonën “Llogaria Ime” (“My Account”) të Platformës së *Portalit Prindi & Familja*, që të ndryshoni fjalëkalimin, ose pyetjet e sigurisë. Ju duhet të zgjidhni tre pyetje të ndryshme sigurie dhe të jepni përgjigjet tuaja, të cilat mund të përdoren për nxjerrjen e fjalëkalimit në rast harrese në të ardhmen. Çdo përgjigje duhet të jetë e gjatë, midis 2 deri në 50 karaktere.

Përgjigjet e sigurisë që jepen në rast të rikuperimit të fjalëkalimit, nuk dallojnë nëse shkronjat janë të mëdha, ose të vogla, por duhet të përputhen me përgjigjen. Sigurohuni që të zgjidhni kombinime të pyetje-përgjigjeve, të cilat janë të vështira dhe nuk mund të hamëndësohen lehtë nga të tjerët.

10. Unë kam harruar fjalëkalimin. Si mund t'a rivendos atë përsëri? Nëse keni harruar fjalëkalimin, klikoni në “Keni Harruar Fjalëkalimin?” (“Forgot Your Password?”) në seksionin e identifikimit (login section) (<https://www.philasd.org/login>), dhe futni adresën e emailit që të filloni procesin. Do t’ju kërkohet t’i përgjigjeni pyetjeve të sigurisë, për identifikimin tuaj. Me dhënien e përgjigjeve, ju do të keni mundësi të rivendosni fjalëkalimin tuaj. Nëse ju keni harruar edhe përgjigjet e sigurisë, ju mund të kërkoni t’ju dërgohet një email, për rivendosjen e fjalëkalimit.

11. Unë kam harruar emrin e përdorimit (username). Si mund t'a gjej atë përsëri? Emri i përdorimit në *Portalin Prindi & Familja*, do të jetë kurdoherë, adresa juaj e emailit. Nëse ju nuk jeni i sigurtë se cilën adresë emaili keni përdorur, klikoni në “Keni Harruar Fjalëkalimin?” (“Forgot Your Password?”) dhe përpikuni në të gjitha adresat e emailit që keni. Nëse adresat e emailit përputhen me atë që ju keni përdorur, ne do të japim pyetjet e sigurisë që keni përdorur. Nëse keni harruar edhe pyetjet e sigurisë, mund të kërkoni t’ju dërgohet një email, për rivendosjen e fjalëkalimit.

12. Unë nuk mund të futem në llogarinë time dhe nuk kam akses në emailin e përdorur për krijimin e llogarisë. Si mund t'a rivendos përsëri llogarinë time? Zyra e Përfshirjes së Familjes & Komunitetit i ka mjete të ndihmojë prindërit dhe kujdestarët që të rivendosin llogarinë e tyre. Ju lutemi kontaktoni Zyrën e Përfshirjes së Familjes & Komunitetit në numrin: (215) 400-4000 për asistencë të mëtejshme. Jini të përgatitur që të jepni informacione që verifikojnë identitetin tuaj.

13. Si mund të lidhem me llogarinë e nxënësve të mi? Nxënësit tuaj do të lidhen automatikisht me llogarinë tuaj, gjatë procesit të regjistrimit. Nëse ndonjë prej fëmijëve tuaj nuk do të shfaqet në llogarinë tuaj, ju lutemi kontaktoni shkollën e fëmijës. Nxënësit e shkollave charter, private, ose fetare, mund të mos jenë në *Portalin Prindi & Familja*.

14. Çfarë është Kodi i Konfirmimit (Confirmation Code)? Kodi i Konfirmimit përdoret si provë që ju jeni prind ose kujdestar gjatë procesit të regjistrimit në llogarinë e *Portalit Prindi & Familja*. Kodi i Konfirmimit kërkohet vetëm një herë gjatë regjistrimit në llogari. Si prind, ose kujdestar ju keni një Kodi të Konfirmimit, pavarësisht sa fëmijë keni të regjistruar në shkollat e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias.

- 15. Kur më duhet Kodi i Konfirmimit?** Regjistrimi në Portal kërkon nga ju të jepni *Kodin e Konfirmimit* gjatë regjistrimit. Ju mund të pajiseni me këtë kod duke kontaktuar shkollën tuaj, ose duke e kërkuar atë online këtu. *Kodi i Konfirmimit* kërkohe vetëm një herë gjatë regjistrimit në llogarinë e *Portalit Prindi & Familja*.
- 16. Pse nuk funksionon Kodi im i Konfirmimit?** *Kodet e Konfirmimit* ndërrohen çdo fillim muaji (ditën e parë të muajit), kështu që është e rëndësishme të kryeni regjistrimin përpara se ai të dalë jashtë përdorimit. Nëse ju nuk e kryeni atë, atëhere, ju duhet të kërkonit një kod të ri nga shkolla juaj, ose të plotësoni procesin e regjistrimit online.
- 17. Si veprohet nëse nuk kam telefon, ose numrat e telefonit të listuar në rekordet e fëmijës janë shkëputur?** Ju mund të merrni *Kodin e Konfirmimit* duke vizituar shkollën e fëmijës tuaj dhe duke dhënë provat e identitetit dhe lidhja familjare që keni me nxënësin.
- 18. Si mund t'a di që të dhënat e fëmijës tim janë private dhe të sigurta?** Drejtoria Arsimore e Filadelfias është shumë e përkushtuar ndaj sigurisë, privatësisë dhe ruajtjes së sekretit të të dhënave të gjithë nxënësve. Drejtoria Arsimore e Filadelfias përdor standardet teknike për qasjen në të dhënat dhe ruajtjen e tyre, përdor komunikim interneti të koduar dhe kufizime në përdorimin e të dhënave. Informacioni i Drejtorisë për praktikatat dhe procedurat e ruajtjes së të dhënave të nxënësve mund të gjenden në: philasd.org/studentdataprivacy.
- 19. Si mund të shikoj rekordet shkollore të viteve të kaluara të fëmijës tim?** Portali Prindi dhe Familja do të japë informacion për vitin aktual shkollor. Informacioni për fëmijën tuaj në vitin shkollor paraprak mund ta gjeni duke klikuar ikonën "Schoolnet" në fund tek Parent & Family Launchpad duke përdorur llogarinë e re të Parent & Family Portal.
- 20. Si mund të shikoj klasat, frekuentimin dhe notat e fëmijës tim?** Futuni në llogarinë tuaj të *Portalit Prindi & Familja* dhe zgjidhni informacionin që dëshironi të shikoni të fëmijës. Të dhënat e mundëshme mund të shihen nëpërmjet tabelave në anën e majtë të ekranit. Klikoni këtu për një video, që shpjegon përdorimin e Portalit.
- 21. Si mund regjistrohem për marrjen e emaileve, tekst mesazheve dhe njoftimeve të tjera nga shkolla e fëmijës tim?** Me krijimin e llogarisë në *Portalin Prindi & Familja*, ju mund të përditësoni preferencat tuaj në marrjen e njoftimeve, duke klikuar **Preferencat e Kontaktimit (Contact Preferences)**, në anën e majtë të ekranit. Secili prej numrave të telefonit mund të vendosen për marrjen e mesazheve zanore, tekst mesazheve SMS, ose të dyja. **JU LUTEMI MOS HARRONI:** Nëse numrat tuaj telefonikë të listuar duhen përditësuar, kontaktoni shkollën e fëmijës.

22. A mund të përdor ndonjë aplikim (App) për këtë qëllim në telefon, ose tablet?

Ju nuk keni nevojë për aplikim që të keni qasje në Portalin Prindi & Familja. Aksesin në portal nga celulari mund të bëhet duke shkuar në: <https://www.philasd.org/login>.

23. Çfarë ikone aplikacioni mund të përdor nga platforma e Portalit Prindi & Familja?

Platforma e Portalit Prindi & Familja përmban ikona të aplikimeve të tilla si: Përzgjedhja e Shkollës (School Selection), “Schoolnet” (informacion i shkollës së fëmijës përpara vitit shkollor 2017-18), dhe pyetësorëve të Drejtorisë Arsimore.

24. Pse nuk mund të përdor ikonat e aplikacionit të platformës “ Prindi & Familja”?

Ikonat për programet e tilla si “Achieve3000, Edgenuity dhe First in Math” që ndodhen në platformën e nxënësit, janë të mundëshme vetëm për nxënësit. Nëse një prind/kujdestar klikon në ndonjë prej këtyre ikonave, ata nuk do të kenë qasje në program.